



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**  
**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË ASETVE DHE KADASTRËS**  
**SEKTORI I KADASTRËS DHE RREGJISTRIMIT TË ASETVE**

Nr. 3848 Prot.

Lezhë, më 01 . 06 .2026

**PROJEKT-VENDIM**

Nr —, Datë, 01/06/2026

“Për

miratim të listës paraprake të pronave të paluajtshme që kërkohet të transferohen rishtaz në pronësi të Bashkisë Lezhë të Qarkut Lezhë.”

Mbështetur në ligjin numër 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1.2 germa a, Ligjit 8744 date 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 2, Neni 3, pika gj) “*Prona të tilla si mjete për funeral, varrezat brendapërbrenda bashkive dhe komunave*” Neni 4, Neni 6, Neni 7, Neni 8, Neni 9, Neni 11, Neni 12, Ligji 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në republikën e shqipërisë” neni 36, neni 37, pika 3 e neni 39, Seksioni IV, Ligji 111/2018 “Për Kadastrën” Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, VKM.nr.28 datë 27.01.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listës së pronave shtetërore dhe rregullave për bashkpunim ndërmjet institucioneve”, Ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 24, Udhëzimin nr 30 dt 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar), të VKM nr 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” si dhe duke qenë se ky proces është i papërfunduar:

**PROPOZOJ:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1. Miratimin e kërkesës për transferimin rishraz në pronësi të Bashkisë Lezhë të pronave të paluajtshme shtetërore sipas formularit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Prona e përcaktuara në pikën 1 do të të përdoret me destinacion “shërbime funerale” në lagjen Kodër Malekaj varrezat në Qytetin e Lezhës. Pasuria me nr.12/A , ZK 8632 .

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për veteqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETARI**

**PJERIN NDREU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**  
**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË ASETETEVE DHE KADASTRËS**  
**SEKTORI I KADASTRËS DHE RREGJISTRIMIT TË ASETETEVE**

Nr. 3848 / Prot.

Lezhë, më 01.06.2026

**RELACION**

**“Për**

**miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohet rishtaz në pronësi të Bashkisë Lezhë, Qarku Lezhë”, për pasuritë, sipas fletës inventarit, lagje Kodër Malekaj ,Bashkia Lezhë.**

**Drejtuar : Këshillit të Bashkisë Lezhë**

**Të nderuar/a zonja dhe zotërinj Këshilltarë !**

Në kuadër të procesit të transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore në administrim të Njësive të Vetqeverisjes Vendore, mbështetur në:

Kushtetutës, neni 11 pika 1. “Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.” pika 2. “Prona private dhe publike mbrohen njëllor me ligj.” pika 3. “Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.”, Neni 13 “Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.”, Neni 41 pika 3. “Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.”, Neni 59 pika d) “një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;”, Neni 95 pika 2. “Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore.”, Neni 100 pika 5. “Këshilli i Ministrave nxjerr vendime dhe udhëzime.”, Neni 109 pika 1. “Organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilat zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.” pika 2. “Organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.”, Neni 113 pika 1. “Këshillat komunalë, bashkiakë dhe të qarkut: a) “rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre;” b) ushtrojnë të drejtat e pronës, administrojnë në mënyrë të pavarur të ardhurat e krijuara, si dhe kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtari ekonomike;” (...) pika 2. “Organet e njësive të qeverisjes vendore nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra ”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ligjin numër 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Neni 8 pika 1. “Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohe me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror.” pika 2. “Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhrave.”, neni 9, pika 1.2. “Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë: a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;”, pika 1.6. “Të drejtën e personit juridik: Si persona juridikë, njësitë e vetëqeverisjes vendore gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë: a) të drejtën e lidhjes së kontratës;”, Neni 28 “Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: 1. Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor. 2. Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë.”, Neni 33 pika 1. “Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme: (...) c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta; ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi.”, Neni 38 pika 5. “Bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për: a) shërbimet publike që ato ofrojnë; b) të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore;”, Neni 36 pika 1. “Të ardhurat nga burime të tjera të bashkive janë: a) të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë; (...) d) të ardhurat nga partneritetet privat-publik.”, pika 2 “Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjobat, ndihmat ose donacionet.”, neni 54, “Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca: (...) e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;”;

Ligjit numër 8743 datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit” i ndryshuar, Neni 2 “Për qëllimet e këtij ligji, përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime: a) “Pronë e paluajtshme e shtetit” kuptohet prona e paluajtshme e pushtetit qendror dhe e njësive të qeverisjes vendore.”, neni 8 pika 3 “Këshilli i Ministrave miraton listën e inventarit të pronave të paluajtshme të shtetit.” i ndryshuar, Ligjit 8744 datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, neni 3 “U transferohen njësive të qeverisjes vendore pronat që përdoren për realizimin e funksioneve dhe/ose shërbimeve për bashkësinë të njohura me ligj, të tilla si: (...) “ç) Pronat që përdoren për realizimin e funksioneve ekonomike.”; pika gj) “Prona të tilla si mjete për funeral, varrezat brendapërbrenda bashkive dhe komunave”

VKM numër 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë të Qeverisjes Vendore” si dhe në Udhëzimin numër 3 datë 18.07.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore”;

Po ju paraqesim një relacion shpjegues në lidhje me projekt-vendimin e marrë nga Kryetari i Bashkisë Lezhë për miratimin e kalimit të pronësisë së listës përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore, që kërkohet të transferohen rishtaz në pronësi të Bashkisë Lezhë, Qarku Lezhë sipas fletës së inventarit, lagjen Koder Malekaj, Bashkia Lezhë.



Mënyrat e fitimit të pronësisë mbi sendet e paluajtshme në vendin tonë mbartin një rëndësi thelbësore për sa i përket kuadrin kushtetues dhe ligjor. Kuadri rregullues i tyre parashikon dhe sanksionon kushtet thelbësore dhe rrugën procedurale që duhet ndjekur nga subjektet e së drejtës për t'u bërë pronar me njërin prej mënyrave të fitimit të pronësisë mbi pasuri të paluajtshme. Pasuria e paluajtshme konsiderohet si një nga elementët kryesorë të çdo kapitali shtetëror.

Duke iu referuar aspektit juridik ai përfaqëson një gamë të gjerë konceptesh, parimesh, institutesh që i bëhen pasurisë së paluajtshme. Në këtë relacion është synuar të jepen të gjitha mundësitë që ofron ligjvënësi shqiptar nëpërmjet parashikimeve ligjore. Pasuria e paluajtshme në qarkullimin juridiko-civil ka karakter jo vetëm të qëndrueshëm, por edhe dinamik, që do të thotë, se në varësi të veprimeve të ndryshme juridike çështjet e të drejtave të pronësisë vazhdojnë të jenë një sfidë për legjislacionin kombëtar dhe të konsiderohen një shqetësim madhor për zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë shqiptare.

Qëllimi kryesor është disimpakti negativ që injektohet në ekonominë e vendit nga problemet e pronësisë. Referuar sistemeve demokratike të pronësisë procesi i privatizimit synon ngritjen e nivelit të jetesës dhe rrjedhimisht në mënyrë të tërthortë paqen sociale, rritje e të ardhurave buxhetore dhe reduktimin e deficitit buxhetor. Efektet e këtij procesi konsistojnë në :

- promovimin e rritjes së eficiencës ekonomike, nëpërmjet pjesëmarrjes së sipërmarrjeve private dhe për rrjedhojë, kënaqjen e kërkesave të konsumatorëve dhe të qytetarëve;
- reduktimin e borxhit publik dhe të jashtëm;
- zhvillimin e tregut kombëtar të kapitaleve;
- forcimin e konkurrencës dhe dobësimin e monopoleve;
- konfrontimin e njësive ekonomike me disiplinat dhe me rregullat e tregut;
- rritjen e cilësisë së produkteve dhe të shërbimeve;
- rritjen e afatgjatë të numrit të vendeve punës dhe rritjen e alternativave të punësimit nëpërmjet mbledhjes së burimeve njerëzore në një treg të lirë duke krijuar kështu edhe një klasë të administratorëve bazuar në aftësitë menaxheriale, të cilët rezultojnë të jenë një bazament me shumë vlerë për stabilitetin politik.

Objektivi parësor i menaxhimit të aseteve është të ndihmojë organizatat në arritjen e një niveli të kërkuar të shërbimit në mënyrën më efektive nëpërmjet krijimit, blerjes, operimit, mirëmbajtjes, rehabilitimit, si dhe pasja e aseteve për të ofruar shërbime për klientët aktualë dhe të ardhshëm, duke siguruar kështu një qëndrueshmëri afatgjatë të organizatave apo kompanive, duke përfshirë edhe shërbimet. Parimet e menaxhimit të aseteve vendore rrjedhin nga eksperiencia dhe arsyetimi praktik, si dhe informojnë menaxhimin strategjik të aseteve dhe zbatimin praktik në aktivin e ciklit të jetës së aseteve.

Duke integruar planin e menaxhimit të aseteve në kuadër të synimeve strategjike të kësaj bashkie, siguron një strukturë për të inkorporuar kërkesat e njësive të aseteve në dokumentacionin e saj më të gjerë strategjik dhe të planifikimit të korporatave. Një kthim "i drejtë", në bazën rregullatore të aseteve të përfaqësuara si të ardhura vendore vjetore, po ashtu, edhe rritja e kapitalit nga një investim, shprehet si përqindje e investimit origjinal.

Qëllimi i menaxhimit të aseteve është për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të bashkisë, si dhe vijueshmërinë e aktivitetit ekonomik të saj, duke rritur treguesit financiar. Pranueshmëria më e madhe e aplikacioneve nga subjektet e ndryshme për tarifatat dhe për mundësitë e rritjes së të ardhurave nga metodologjitë efikase menaxheriale, duhen të përdoren si për NJVQV-ve, ashtu, edhe për palët e interesuara dhe për leverdishmërinë e komunitetit. Identifikimi dhe përqendrimi i përparësive për projektet në përmirësime kapitale ndaj aseteve me leverdishmëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ekonomike e sociale, përmbushin nevojat e vërteta të NJVQV-ve, duke i kthyer më atraktive për donatorët potencial të huaj e vendës, duke konsideruar dhe PPP-të.

Bashkia Lezhë për të arritur përputhshmërinë ligjore të titujve të pronësisë, me qëllim zbatimin e kërkesave të ASHK Tiranë, me shkresën nr 10420/1 prot., dt 30.06.2020, të cilët citojnë se nevojitet statusi juridik i azhornuar, si dhe HTR e përditësuar, verifikimin e gjendjes faktike në terren, ju paraqesim shkresën e ASHK DV Lezhë, me statutet juridike të përditësuara.

Kemi dërguar shkresën me nr.20874 pret, date 09.12.2025, si dhe shkresën me nr.6220 prot datë 07.05.2026 .Kërkesë për informacion.

ASHK DV Lezhë, ka dërguar shkresën me nr.6576/2 prot,dt.08.04.2026, pranë Bashkisë Lezhë, Nr. i pasurisë:12/A , ZK 8632 me sipërfaqe 53953 m<sup>2</sup> nuk është e azhornuar.

1.Nr. i pasurisë:12/A , ZK 8632 me sipërfaqe 53953 m<sup>2</sup>.

Miratimin që kjo pronë të përdoret me destinacion “shërbime funerale” për qytetin e Lezhës. Pasurite me nr.12/A ZK 632 sip 53953 m<sup>2</sup>

Referuar sa më sipër i drejtohem Këshillit Bashkiak Lezhë, “Për Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet për transferim rishtaz në pronësi të Bashkisë Lezhë”, për dërgimin e listës së inventarit, të pronave të paluajtshme shtetërore, që kërkohet të transferohen në pronësi të Bashkisë Lezhë, Qarku Lezhë, pasi është kërkesë urgjente për gjetjen dhe për ndërtimin e varrezave , shërbimet funerale për qytetin Lezhë.

KRYETARI

PJERIN NDREU



1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUJTSHME SHPETËRORE

(Për Inventarizimin e Pronave të Vecanta)

BASHKIA LEZHË, BASHKIA LEZHE

Identifikoi Ing. Nderim Muçaj, (Topograf)  
(Emër, Mbiemër, Pozicioni Zyrtar)



Supervizoi Gjek Makaj (Drejtori i Kadasres & S.M.A.)  
(Emër, Mbiemër, Pozicioni Zyrtar)



Fusha e Përdorimit të Pronës : Sherbim Funeral.

Aprovoji Pjerin Ndreu (Kryebashkiaku)  
(Emër, Mbiemër, Pozicioni Zyrtar, firma, vula)



Nr rendor	A			B			C			
	Zona Kadastrale & Indeks i Hartës	Nr i Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës, Adresa	Sip Totale e Pronës (m <sup>2</sup> )	Nga Sip Totale sa Ndërtesë (m <sup>2</sup> )	Funksioni për të cilën Përdoret Prona	Institucioni / Enti me Përgjegjësi Administrative	Institucioni / Enti Përdorues, Statusi Juridik i Përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të Vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8632 LE-C1	12/A		Lagje Kodër Marlekaj	53953	0	Shërbim Funeral	Bashkia Lezhë	Bashkia Lezhë	



R E P U B L I K A E S H Q I P E R I S E

BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË ASETVE DHE KADASTRËS  
SEKTORI I KADASTRËS DHE RREGJISTRIMIT TË ASETVE

Nr. 20074 prot

Lezhë me. 08.12 2025

**Lënda:** Kërkesë për informacion.

ASHK .DV LEZHË


Në zbatim të Ligji 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" Neni 8 pika 1, pika 2, neni 9, pika 1.2, 1.6, Neni 23, pika 9, neni 35, pika 5, Neni 36, pika 1, pika 2, neni 53 pika 3, neni 54, Ligji 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar, Ligji 8744 date 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 2, Neni 4, Neni 6, Neni 7, Neni 8, Neni 9, Neni 11, Neni 12, Ligji 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në republikën e shqipërisë" Seksioni IV, Ligji 111/2018 "Për Kadastrën", VKM.nr.28 datë 27.01.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listës së pronave shtetërore dhe rregullave për bashkpunim ndërmjet institucioneve, Ligjit 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", Udhëzimin nr 3 dt 18.07.2002 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore" Udhëzimin nr 15 dt 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike", VKM 500 dt 14.08.2001, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore".

*Kërkojmë nga ana juaj informacion mbi statusin juridik + fragment harte treguse, për pasurinë me nr.12/A, ZK 8632 sip.53953 m<sup>2</sup>, si dhe hapje kartele .*

Faleminderit për mirëkuptimin!

NË MUNGESË DHE ME URBHËR  
SEKRETARI I PËGJITHSHËM

Reinis ÇELA



KRYETARI  
Pjerin NDREU

**N RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE**

DATE 05.11.2025

QËLLIMI: Per inventarizim/transferim prone.

ZONA KADASTRALE 8632

NR. I PASURISË 12/A

INDEX HARTE: LE-C-1,C-2,D-1,D-2


2

SIP.E GJURMËS SË NDËRTIMIT -

NR. I KATEVE-

NR. I PEMEVE-

X=469736.25  
Y=4629050.98



1

D-2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
DREJTORIA VENDORE LEZHË

Nr. 6576/2 Prot.

Lezhë, më 08.04.2026

Lënda: Përgjigje shkresës nr.20874Prot date 09.02.2026

**BASHKISË LEZHË**  
**DREJTORISE SE ADMINISTRIMIT TË ASETEVE DHE KADASTRËS**  
**SEKTORI I KADASTRES DHE RREGJISTRIMIT TE ASETEVE**

**LEZHË**

Në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë është administruar me numër 6576 Prot., shkresa me nr 20874 Prot date 9.02.2026 te Bashkisë Lezhë ku kërkohet informacion per gjendjen juridike te pasurise sipas plan rilevimit 12/A ZK 8632

Sa me siper ju sqarojme se ne harten kadastrale pasuria sipas plan rilevimit i perket pjese te pa azhornuar ne zk 8632

Bashkelidhur po ju vendosim në dispozicion harten e punes se pasurive

**Ju bëjmë me dije se në vazhdimësi, bazuar në VKM-në nr.389, datë 13.05.2020 “Për Miratimin e Listës dhe Tarifave të Shërbimeve Kadastrale”, kërkesat tuaja duhet të paraqiten online sipas: Pika 9.1 , Pika 9.2 sipas së cilës “Ato duhet t’i shlyejnë drejtorisë vendore të ASHK-së, çdo muaj, shumën e tarifave të shërbimeve kadastrale të ofruara në favor të tyre gjatë muajit paraardhës.**

Duke ju falenderuar per bashkepunimin.

Me respekt.

**DREJTORI**  
**ALTIN GJERGJI**

Altin

Gjergji

Digitally signed by Altin  
Gjergji  
Date: 2026.04.20  
11:08:28 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Lezhë  
Date:2026/04/20 11:43:52 +02'00'  
14rcLEZHE2026042011434542014

Adresa: Rr. “Kuvendi i Arbërit”, Lezhë, ashk.gov.al

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Lezhë)



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ONA KADASTRALE: 8632

KODI UNIK: -

JUMRI PASURISË : -

INDEX I HARTËS: LE-C1

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH: 1:2500

DREJTORI  
ALTIN GJERGJI

Data eleshimit 16/01/2026  
Altin  
Gjergji

Digitally signed by Altin  
Gjergji  
Date: 2026.02.10  
16:14:07 +02'00'

SHPJEGUES

- PARCELA
- NDRËFTESA



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Lezhë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË ASETVE DHE KADASTRËS  
SEKTORI I KADASTRËS DHE RREGJISTRIMIT TË ASETVE

Nr. 6220 Prot.

Lezhë, më 7/5 2026

Lënda : Kërkesë për bashkëpunim dhe dokumentacion.

ASHK.DV LEZHË

Në vijim të shkresës me nr. 20874 prot, dt 09.02.2026 ,si dhe në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”Neni 8 pika 1, pika 2, neni 9 pika 1.2,1.6, Ligji 8744 ,datë 22.02.2001.”Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore ” i ndryshuar neni 2, neni 4,neni 6 ,neni 7, neni 8,neni 9, neni 11,neni 12, Ligji 20/2020 “Për përfundimin e proqesit të kalimit të pronave publike të transferuara në pronësi të vetqeverisjes vendore”,neni 39, Seksioni IV,Ligji 111/2018 “Për kadastrën” Kreu IV,Kreu ,V Kreu VII , VKM 500 dt 14.08.2001,”Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njesitë e qeverisjes vendore”.Kërkojmë nga ana juaj asistencë apo pjesmarrje (ASHKDV Lezhë) siç e parashikon VKM nr.28, datë 27.01.2023 ,Pika 1,gërma a ,b, Pika 2 gërma a,b,c,d,ç,dh. kreu 2,pika 3, gërma a,b,c,c,d,dh. Në vijim të punës për rregjistrimin e pronave të Bashkisë Lezhë, kërkojmë nga ana juaj ,verifikimi në terren dhe hapjen e karteles së pasurisë me nr.12/A , ZK 8632 si dhe fragment harte.

*Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!*

KRYETARI

Pjerin NDREU

NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Reinis ÇELA



Konceptoi : A. Pjetri  
Pranoi :E.Mani  
Miratoi .N.Shtjefni.  
Kop.nr. 3 .

LEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

DATE 05.11.2025

QELLIMI: Per inventarizim/transferim prone.

ZONA KADASTRALE 8632

NR. I PASURISE 12/A

INDEX HARTE: LE-C-1,C-2,D-1,D-2

2

SIP.E GJURMËS SË NDËRTIMIT -

NR. I KATEVE:-

NR. I PEMËVE-

X=469736.25  
Y=4629050.98

B-1

B-1

C-1

12/A

S=53953 m2

C-2

D-1

D-2